

KËRKESË
Nr. 4572/8, datë 27.4.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Brendshme, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: “Rikonstruksion i rrugës unaza Patos”, në Bashkinë Patos.

Subjekti kërkues është Bashkia e Patosit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 620.939,15 (gjashtëqind e njëzetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë presje pesëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I BRENDSHËM
Romina Kuko

**TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR
INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE TË CILAT PREKEN NGA OBJEKTI:
"RIKONSTRUKSION I RRUGËS UNAZA PATOS", BASHKIA PATOS**

Nr	Emer Mbiemer	Zona Kadas.	Nr	m2			shpron.	çmimi	Vlera truall	Sip ndertes m2		Vlera ndertes	Vlera totale	Gjendja juridike
			Pasur.	truall	banesë	njësi	m2	lek/m2	lekë	preket	shpro.	lekë	lekë	
1	Lefter Rauf Manaj	2890	4/130	19		19	19	2848.00	54112.00	19.00	19.00	566827,15	620939,15	Konfir. ZVRPP
													620939,15	